



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË

DREJTORIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

DREJTORIA E PËRGJITHSHME DETARE

DURRËS

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

Periudha e audituar

01.01.2017-31.12.2019

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

“Drejtoria e Përgjithshme Detare” (DPD), është institucion i financuar nga Buxheti i Shtetit. DPD është autoriteti përgjegjës për funksionimin e administratës detare, për politikat e zhvillimit dhe monitorimit të transportit detar.

DPD ushtron detyrat dhe përgjegjësitë e saj në përputhje me Ligjin nr. 10109, datë 02.04.2009 “Për Administratën Detare të Republikës së Shqipërisë”.

Objekti i auditimit: Auditim mbi rregullshmërinë e funksionimit të sistemit të pagave dhe personelit dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësimin e sistemit.

Për identifikimin e sistemeve, grupi i auditimit u bazua në raportet e mëparshme të auditimit dhe dispozitat e organizimit dhe funksionimit, strukturën organizative dhe dokumentacionin e mbajtur.

Sistemet e identifikuar, për përmbushjen e objektivave të auditimit dhe të përcaktuara në programin e miratuar të auditimit është Sistemi i pagave të punonjësve dhe Proceset gjyqësore në lidhje me marrëdhëniet e punës.

Qëllimi i Auditimit: T’i japë siguri menaxhimit se kontrollet e brendshme dhe procedurat në sistemin e pagave dhe personelit kanë funksionuar në mënyrë eficiente për përmbushjen e objektivave në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

Periudha objekt auditimi: 01.01.2017 – 31.12.2019.

Rezultatet e auditimit, përmbledhje e gjetjeve:

DPD është bërë pjesë e institucioneve të shërbimit civil me hyrjen në fuqi të ligjit 152/2013, “Për Nëpunësit Civilë” i ndryshuar.

Në vitin 2017, janë emëruar 3 nëpunës si dhe është kryer 1 transferim i përkohshëm në kundërshtim me procedurat e parashikuara në ligjin 152/2013, “Për Nëpunësit Civilë” i ndryshuar dhe akteve ligjore të dala në zbatim të tij.

Me përjashtim të 4 rasteve, të gjithë emërimet apo transferimet e nëpunësve janë kryer nëpërmjet procedurave konkurruese të zhvilluara nga DAP.

Opinion mbi vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm

Komponentët e kontrollit të brendshëm janë vlerësuar nga niveli i lartë i menaxhimit, është organizuar sistemi i emërimit dhe transferimit të punonjësve, janë respektuar ligjet në fuqi për përcaktimin e sistemit të pagave, janë menaxhuar dosjet e personelit si dhe janë kryer likuidimet e pagave dhe pagesave të tjera të lidhura me to në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore.

Vlerësimi i riskut: Mbështetur në informacionin e disponuar në vlerësimin e funksionimit të sistemit, realizimin e objektivave dhe konstatimet e paraqitura në këtë material për periudhën e audituar, grupi i auditimit paraqet opinionin për vlerësimin e përgjithshëm të *riskut në nivel të ulët*.

II. HYRJE

Auditim i përputhshmërisë ka për qëllim vlerësimin e procedurave në sistemin e pagave dhe personelit, nëse ky sistem ka funksionuar në mënyrë eficiente për përmbushjen e objektivave në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

Auditimi u krye mbështetur në dispozitat ligjore, përsa më poshtë vijon:

Ligji nr.114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”,

Ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar”;

Ligji nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar;

Ligji nr. 8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar;

Ligji nr.9251, datë 08.07.2004 “Kodi Detar i RSH”, i ndryshuar;

Ligji nr.10109, datë 02.04.2009 “Për Administratën Detare të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 9281, datë 23.09.2004 “Për sigurinë në anije dhe në porte”;

LIGJ nr.152/2013 “Për Nëpunësin Civil” (ndryshuar me ligjin nr. 178/2014 dhe ligjin 41/2017

VKM nr.545, datë 11.8.2011 “Për miratimin e strukture dhe niveleve të pagave...” i ndryshuar dhe shfuqizuar me VKM Nr. 187, datë 8.03.2017;

VKM nr.717, datë 23.06.2009 “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucione buxhetore”, i ndryshuar dhe shfuqizuar me VKM nr.202, datë 15.03.2017;

VKM nr.125, datë 17.2.2016 “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të Nëpunësve Civilë”;

VKM nr.117, datë 5.3.2014 “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”.

Rregullorja e brendshme e funksionimit të subjektit, si dhe ç’do dispozite ligjore e nënligjore që rregullon marrëdhëniet e këtij subjekti.

Auditimi është kryer në zbatim të Urdhërit të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë Nr. 253, datë 04.09.2020, dhe Programit të Angazhimit të Auditimit për RDSH me nr. 6339/2 prot., datë 21.09.2020.

Auditimi u krye nga grupi i punës i përbërë nga:

1. Merita Gjoka - përgjegjës grupi;
2. Ardiana Alimeri - anëtare.

III. METODA E AUDITIMIT

Metoda e përdorur në auditim është “testimi hap pas hapi” dhe e kombinuar me metodën e ekzaminimit, për të cilën u përzgjedhën transaksione specifike brenda çdo sistemi nga fillimi deri

në fund, për të vlerësuar nëse institucioni i është përmbajtur procedurave të caktuara si dhe për të dhënë një gjykim profesional në lidhje me përshtatshmërinë dhe efikasitetin e veprimeve të subjektit të audituar.

Teknika e përzgjedhjes në mënyrë rastësore u kombinua dhe me teknika të tjera si kontrolli aritmetik (listë pagesat, përlllogaritjen e pagave, ditarët analitik, etj), shqyrtimi i dokumentave justifikuese e krahasimi me dokumentin bazë dhe ekzaminimin analitik (në të gjithë sistemet e audituara sipas programit).

Për çdo nënsistem të mbuluar me auditim u përzgjedhën mbi 25 % të transaksioneve, procedurave të zhvilluara ose të veprimeve të kryera.

Në përfundim të misionit të auditimit, mbështetur në konkluzionet e nxjerra nga vlerësimi i të gjithë dokumentacionit të veprimtarisë audituese, u hartua Projekt Raporti, i cili ju vu në dispozicion entitetit të audituar.

IV. GJETJET KONKLuzionET DHE REKOMANDIMET PËR CDO SISTEM

Në përfundim, grupi i auditimit pasqyron vlerësimin e sistemit dhe fushave, respektivisht sipas programit të auditimit, si më poshtë vijon:

1. Sistemi i pagave të punonjësve.

Marrëdhëniet e punës të punonjësve të Drejtorisë së Përgjithshme Detare, rregullohen në bazë të Ligjit 152/2013, “Për Nëpunësit Civilë”, dhe VKM nr.116, datë 05.03.2014, “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civilë” dhe Ligjin nr.7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

i. Miratimi dhe zbatimi i strukturës organike të miratuar për periudhën objekt vlerësimi.

Për periudhën vjetore 2017, Struktura dhe Organika e DPD, është miratuar me Urdhër Kryeministri nr. 73, datë 21.04.2016 “Për miratimin e strukturës dhe organikës për Drejtorisë së Përgjithshme Detare”, i ndryshuar me Urdhër Kryeministri nr. 165, datë 08.11.2016, me numër të përgjithshëm 71 punonjës.

Struktura dhe organika e institucionit ka të përcaktuar, emërtimin e pozicioneve të punës dhe numrin e punonjësve gjithsej. Struktura ofron vija të qarta të përgjegjësive dhe të kalimit të informacionit, lejon monitorimin e veprimtarisë së institucionit nga Titullari i Institucionit dhe e ndihmon atë në vendimmarrje.

Organika e DPD-së, për periudhën që auditohet, përbëhet nga:

Pozicioni	Kategoria	Nr. i Punonjësve
Drejtor i Përgjithshëm	II-a	1
ZV/Drejtoir i Përgjithshëm	II-b	1
Drejtor Drejtorie	III-a	2
Përgjegjës sektori	III-a/1	5

Kapiten i portit	III-a/1	4
Përgjegjës sektori	III-b	1
Inspektor	III-b	41
Specialistë	IV-a	11
Specialistë	IV-b	2
Punonjës me Klasa		3
TOTALI		71 punonjës

Numri faktik i punonjësve sipas strukturës në fillim të vitit 2017, ka qenë 66 punonjës, gjatë vitit janë punësuar nëpërmjet procedurave konkurruese me DAP 2 punonjës dhe janë larguar 9 punonjës. Në fund të vitit 2017 sipas strukturës janë të punësuar 61 punonjës dhe 10 vënde janë vakante.

Arsyjet e largimit të 9 punonjësve rezultojnë si më poshtë:

- Z. G.H, ish titullari i institucionit është liruar nga pozicioni i rregullt Drejtor i Përgjithshëm i DPD nga Departamenti i Administratës Publike me shkresën nr. 6289/1 prot., datë 02.11.2017.
- Z. P.Xh për arsye personale ka kërkuar pezullimin e statusit të nëpunësit civil.
- Z. Xh.T humb jetën.
- Z. E.Z më datë 06.01.2017, ndërprerje e përkoshme për shkak të fitimit të mandatit të deputetit në legjislaturën e VIII-të dhe rikthehet në punë më datë 07.12.2017 mbas mbarimit të mandatit si deputet, në të njëjtin pozicion.
- Z. F.K me shkresën nr. 1469/4 prot., datë 06.04.2017 është emeruar përkohësisht nga DAP deri në rënien e shkakut të pezullimit (mbarimin e mandatit të deputetit të Z. E.Z në legjislaturën e VIII-të).
- 4 punonjës përkatësisht, Z. S.P, Z. D.Z, Z. V.N, Z. E.C janë larguar nga detyra pas raportit përfundimtar të inspektimit të bërë nga DAP dhe dërguar në DPD me shkresën nr. 5474 prot., datë 11.09.2017. Në të është kërkuar ndërprerja e marrëdhënies së punës për këto nëpunës pasi akti i emërimit i tyre nga Drejtori i Përgjithshëm i DPD është i pavlefshëm dhe nuk është në përputhje me procedurat e parashikuara të Ligjit 152/2013, “Për Nëpunësit Civilë” i ndryshuar.

Numri faktik i punonjësve sipas strukturës në fillim të vitit 2018, ka qenë 58 punonjës, gjatë vitit janë punësuar nëpërmjet procedurave konkurruese me DAP 6 punonjës dhe 1 punonjës emërim shofer dhe 6 punonjës janë larguar. Në fund të vitit 2018 sipas strukturës janë të punësuar 60 punonjës dhe 11 vënde vakante.

Arsyjet e largimit të 7 punonjësve janë si më poshtë:

- 3 punonjës janë larguar me dorëheqje për arsye personale të cilët janë Z. G.T, Z. E.N dhe Z. E.Z.
- Zj. K.T është ndërprerë marrëdhënia financiare se ka mbushur moshën për pension.
- Z. A.Rr është largua me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm me nr.132 /3 prot., datë 03.01.2018. Arsyja e largimit është akti i emërimit nga ish Drejtori i Përgjithshëm i DPD i cili është i pavlefshëm dhe nuk është në përputhje me procedurat e parashikuara të Ligjit 152/2013, “Për Nëpunësit Civilë” i ndryshuar.
- Z. P.K. Nga Dap është dërguar shkresa me nr. 3436/1 prot., datë 18.05.2018 ku është kërkuar zbatimimi i Ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që

zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” dhe Vendimi i Kuvendit të R.SH nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”” pasi nga verifikimi i të dhënave të deklaratës në formularin e vetëdeklarimit, ky subjekt nuk ka pasqyruar të dhëna lidhur me masa sigurime, hetime, dëbime apo me vendime penale të formës së prerë brenda apo jashtë teritorit R.Sh. Subjekti është dënuar me vendim penal të formës së presë nr. 120, datë 08.02.2018 nga Gjykata e rrethit, Durrës. Me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të DPD nr. 713/4, datë 25.05.2018 është liruar nga detyra.

Numri faktik i punonjësve sipas strukturës në fillim të vitit 2019, ka qenë 65 punonjës, gjatë vitit janë punësuar nëpërmjet procedurave konkurruese me DAP 8 punonjës dhe 2 janë larguar. Në fund të vitit 2019 sipas strukturës janë të punësuar 66 punonjës dhe 5 vënde vakante.

Arsyjet e largimit të dy punonjësve janë:

- Z. A.G është larguar më dorëheqje për arsye personale.
- Z. B.P është larguar me Vendim të Komisionit Disiplinor të DPD nr. 2083/7 prot., datë 01.10.2019, i cili është njoftuar me shkresën nr. 2083/8 datë 04.10.2019 nga DPD. Për çdo ankesë mund ti drejtohet Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, brenda 45 ditëve. Nga pënnunësi nuk është ndjekur rruga administrative ligjore.

Për vitin 2017, numri mesatar i punonjësve sipas bilancit është 68 punonjës, me fond page në shumën 67,287,100 lekë. Në këtë numër përfshihen edhe 3 punonjësit me kontratë të përkohshme.

Për vitin 2018, numri mesatar i punonjësve sipas bilancit është 62 punonjës, me fond page në shumën 63,199,347 lekë. Në këtë numër përfshihen edhe 2 punonjësit me kontratë të përkohshme.

Për vitin 2019, numri mesatar i punonjësve sipas bilancit është 62 punonjës, me fond page në shumën 70,105,852 lekë. Kanë pasur 5 punonjësit me kontratë të përkohshme që nuk janë përfshirë në numrin total.

Nga auditimi i të dhënave në listëpagesat e punës, duke i kryqëzuar me përcaktimet e emërtimeve në strukturë, për vitit 2017-2019, rezulton se:

Për peridhën objekt auditimi, struktura ka mbetur e pandryshuar, pasi vijon të jetë struktura e miratuar me Urdhër Kryeministri nr.73, datë 21.04.2016, i ndryshuar me Urdhër nr. 165, datë 08.11.2016.

Në asnjë rast nuk është tejkaluar struktura organizative, për Drejtorisë së Përgjithshme Detare, me numër të përgjithshëm 71 punonjës.

ii. Procedurat e emërimit, lëvizjeve paralele apo ngritjen në detyrë të nëpunësit civil.

Drejtorja e Përgjithshme Detare është bërë pjesë e shërbimit civil në zbatim dhe me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

Gjatë procedurave të përfitimit të statusit të nëpunësit civil, me shkresën e DAP dërguar DPD nr.3056/2, datë 22.10.2014 “Mbi statusin e punonjësve që nuk plotësojnë nivelin e kërkuar të

diplomës”, janë konstatuar se 27 punonjës duhet të plotësojnë kriterin e diplomës për pozicione të ndryshme .

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji dhe akteve nënligjore në zbatim të tij rezulton se kanë fituar menjëherë **statusin 7 punonjës nga 17 dosjet e audituara**, në përputhje me pikën 1, të Kreut III “Statusi i punonjësve ekzistues në institucionet e administratës shtetërore dhe komunat” të VKM Nr. 116, datë 5.3.2014 (ndryshuar me VKM nr.532, datë 06.08.2014) “Për Statusin e Nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil”, ku citohet se:

*“Punonjës ekzistues”, sipas pikës 3 të nenit 67 të ligjit nr. 152/2013, që kryejnë funksione të shërbimit civil në institucionet e administratës shtetërore e komuna, dhe: a) janë rekrutuar sipas procedurave të ngjashme me ato të përcaktuara nga ligji nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, por që nuk e gëzojnë statusin e nëpunësit civil; apo b) janë të punësuar në të njëjtin vend pune për një periudhë jo më të vogël se një vit, **janë nëpunës civilë për shkak të ligjit.***

Pas plotësimit të dokumentacionit dhe kriterit të diplomës, dhe pas konfirmimit nga DAP të secilit prej punonjësve, rezulton se, 1 punonjës z. I.Duka është përcaktuar si punonjës i cili nuk plotëson nivelin e kërkuar të diplomës, pas kalimit të afatit 2 vjeçar, sipas përcaktimeve të pikës 6/1, të Kreut III “Statusi i punonjësve ekzistues në institucionet e administratës shtetërore dhe komunat” të VKM Nr. 116, datë 5.3.2014 (ndryshuar me VKM nr.532, datë 06.08.2014) “Për Statusin e Nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil”, ku citohet se

“Punonjësit e institucioneve të varësisë, pjesë e administratës shtetërore, të cilët bëhen pjesë e shërbimit civil si pasojë e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe që në momentin e deklarimit të statusit nuk plotësojnë kriterin e nivelit të diplomës së arsimit të lartë, të pozicionit të punës ku janë të emëruar, të vazhdojnë të punojnë në pozicionet ku janë të emëruar me kushtin që, brenda një afati 2 vjeçar, të plotësojnë këto kushte.

Në vijim të procedurave të plotësimit të kushteve të këtij punonjësi, i cili në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar, nuk plotëson kriterin e diplomës u la periudhë prove 2 vjeçare për të vazhduar të punojë në pozicionin ku ishte emëruar “Kapiten i Portit Sarandë” me kushtin që, brenda një afati 2 vjeçar, të plotësojnë kriterin e diplomës.

Me shkresën e drejtorit të DPD nr. 381, datë 27.09.2016, është njoftuar z.I.D se, afati për plotësimin e kriterit të diplomës është data 30 Tetor 2016.

Me shkresën e z.Duka drejtuar DPD nr.381/3, datë 20.10.2016, “Ankim Administrativ”, informon se e ka të pamundur plotësimin e këtij kushti dhe kërkon pezullimin e veprimeve të mëtejshme që lidhen me konfirmimin e statusit të Nëpunësit Civil.

Ky ankim administrativ nuk është marrë në konsideratë nga DPD, pasi në zbatim të ligjit të nëpunësit civil, është kompetencë e DAP.

Gjithashtu, DPD ka informuar DAP si dhe ka kërkuar interpretim ligjor në lidhje me këtë çështje.

Me Urdhër të Kryeministrit nr.73, datë 21.04.2016 “Për miratimi e strukturës dhe të organikës së Drejtorisë së Përgjithshme Detare”, ndryshuar me Urdhër **nr.165, datë 08.11.2016** është miratuar struktura e re e këtij institucioni.

Në kuadër të ristrukturimit të institucionit, janë zhvilluar të gjitha procedurat e parashikuara në pikën 3 të nenit 50 “Transferimi në rastin e mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit”, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar, në të cilën citohet se:

“Në çdo rast mbylljeje apo ristrukturimi krijohet një komision ristrukturimi. Komisioni shqyrton mundësitë e sistemimit të çdo nëpunësi civil në vendet e lira ekzistuese dhe propozon transferimin e nëpunësit në një pozicion të lirë, në të cilin ai plotëson kërkesat specifike. Vendimi përfundimtar i transferimit merret nga njësia përgjegjëse, në bazë të propozimit të komisionit”.

Me shkresën e DAP nr. 7918/3, datë 30.03.2017, “Transferim për shkak të ristrukturimit të institucionit”, pas shqyrtimit të propozimit të Komisionit të Ristrukturimit, **është vendosur nga DAP, në cilësinë e njësisë përgjegjëse**, se Z.Duka transferohet në pozicionin “Inspektor në Kapitenerinë e Portit Sarandë”.

Me shkresën e DPD nr.137/14, datë 03.04.2017 “Mbi fillimet e marrëdhënieve të punës dhe ato financiare”, njoftohet z.Duka për transferimin për shkak të ristrukturimit të institucionit, duke filluar nga data 01.04.2017.

Për këtë transferim është marrë edhe deklarata e nënshkruar nga punonjësi, në përputhje me kërkesat e pikës 20 të Kreut II “Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit” të VKM Nr. 125, datë 17.2.2016, “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”, në të cilën citohet se:

“Njësia përgjegjëse, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e marrjes së propozimit nga komisioni i ristrukturimit, vendos për transferimin e nëpunësit civil, njofton nëpunësin civil për vendimin dhe merr mendimin e tij me shkrim. Nëpunësi civil duhet të japë mendimin e tij me shkrim brenda 5 (pesë) ditëve nga data e marrjes së njoftimit”.

Për periudhën objekt auditimi është kryer inspektim nga DAP në zbatim të Urdhërit nr.90, datë 05.06.2017 me objekt “Për inspektimin e zbatimit të legjislacionit të shërbimit civil”.

Në përfundim të inspektimit janë konstatuar se nga Titullari i DPD janë emëruar 3 nëpunës si dhe është kryer 1 transferim i përkohshëm në kundërshtim me procedurat e parashikuara në ligjin 152/2013, “Për Nëpunësit Civilë” i ndryshuar dhe akteve ligjore të dala në zbatim të tij.

Raporti përfundimtar i inspektimit të DAP është dërguar në DPD me shkresën nr. 5474 prot., datë 11.09.2017, ku është kërkuar ndërprerja e marrëdhënies së punës për këto nëpunës pasi akti i emërimit i tyre nga Drejtori i Përgjithshëm i DPD është i pavlefshëm dhe nuk është në përputhje me procedurat e parashikuara të Ligjit 152/2013, “Për Nëpunësit Civilë” i ndryshuar. Këta punonjës janë larguar nga institucioni.

Për periudhën e mëtejshme, pas inspektimit nga DAP, të gjithë nëpunësit të cilët janë emëruar apo transferuar janë kryer nëpërmjet procedurave konkurruese të zhvilluara nga DAP.

Kështu, në vitin 2017 janë emëruar 2 punonjës, në vitin 2018 janë emëruar 6 punonjës dhe në vitin 2019 janë emëruar 8 punonjës.

Si përfundim:

DPD është bërë pjesë e institucioneve të shërbimit civil me hyrjen në fuqi të ligjit 152/2013, “Për Nëpunësit Civilë” i ndryshuar.

Në vitin 2017, janë emëruar 3 nëpunës si dhe është kryer 1 transferim i përkohshëm në kundërshtim me procedurat e parashikuara në ligjin 152/2013, “Për Nëpunësit Civilë” i ndryshuar dhe akteve ligjore të dala në zbatim të tij.

Me përjashtim të 4 rasteve, të gjithë nëpunësit të cilët janë emëruar apo transferuar janë kryer nëpërmjet procedurave konkurruese të zhvilluara nga DAP.

Punonjës rezultojnë të jenë pajisur me Aktin e Deklarimit të Statusit të Punësimit me shkresën e Departamentit të Administratës Publike në vitin 2014-2015, në mbështetje të nenit 67, të Ligjit 152/2013, “Për Nëpunësit Civilë”, kreut III, pika 1 e VKM nr.116, datë 05.03.2014, “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civilë”.

Marrëdhëniet e punës për punonjësit me kontratë rregullohen në bazë të Ligjit nr.7961, datë 12.07.1195, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

iii. Respektimi i ligjshmërisë dhe rregullshmërisë për pagesat e punonjësve, pagesa të prapambetura, llogaritja e pagave në përputhje me vendin e punës dhe pagën e miratuar, përpilimi i dokumentacionit vërtetues të prezencës në punë të punonjësve.

Për periudhën 01.01.2017 deri më 31.12.2019, niveli i pagave për punonjësit e DPD, është mbështetur në VKM Nr. 545, datë 11.08.2011 “Përmiratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, Zëvendës/ministrit dhe Nëpunësve të Kabineteve në Kryeministri ...” i ndryshuar dhe shfuqizuar me VKM Nr. 187, datë 8.03.2017 dhe për punonjësit me klasa në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.717, datë 23.06.2009 “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucione buxhetore”, i ndryshuar dhe VKM nr.202, datë 15.03.2017.

Nga auditimi mbi emërimet dhe përputhjen e nivelit të diplomave me kërkesat e vendit të punës, pages së miratuar konstatohet se, janë respektuar kërkesat e VKM Nr. 545, datë 11.08.2011 “Përmiratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, Zëvendësministrit dhe Nëpunësve të Kabineteve në Kryeministri ...” i ndryshuar me VKM Nr. 187, datë 8.03.2017, në lidhje me llogaritjen e të gjitha elementëve të pages së miratuar, duke përfshirë edhe nivelin e diplomës.

Në lidhje me evidentimin e pjesëmarrjes në punë, saktësinë e përlllogaritjes së elementëve të pagës, zbritjet/ndalesat mbi page dhe derdhja e tyre në llogari, u auditua me zgjedhje dokumentacioni. Pagat dhe listepagesat së bashku me urdhër shpenzimet janë të nënshkruara nga

nëpunësi autorizues dhe zbatues sipas sistemit të dy nënshkrimeve në përputhje me ligjin Nr. Ligjin nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 22.

Sa më sipër u konstatua se:

➤ Listëpagesat e punonjësve që shërbejnë për pagesë, janë hartuar me të gjithë elementët e nevojshëm (të punësuarit, emërtesa sipas strukturës, ditë pune, kategoria/klasa, paga e grupit, paga për funksion, raportet, shtesat pagës për vjetësi në punë, shtesat për vështirësi, ndalesat për tatim page, sig. shoqërore, shëndetësore, etj). Listëpagesat janë mbështetur në listëprezencat mujore dhe në asnjë rast nuk rezulton të ketë mospërputhje. Pagesat e punonjësve bëheshin çdo muaj mbi bazën e kohëshënuesit i shoqëruar rast pas rasti me shkresat për lejet vjetore, me raporte për paaftësi të përkohshme në punë etj, për emërimet të reja, për lëvizje nga një pozicion pune në tjetrin, etj.;

➤ Pagesat e kryera rakordohen me pagesat e paraqitura në sistemin e llogarisë (librin e përgjithshëm të llogarive) dhe janë pasqyruar në regjistrin e pagave, i cili mbahet në mënyrë elektronike dhe i printuar;

➤ Çdo punonjës ka numrin e tij të identifikimit;

➤ Në listë pagesat që u përzgjedhën për auditimi janë përlllogaritur, ndaluar dhe xhiruar, detyrimet për tatimet mbi të ardhurat personale si dhe kontributi për sigurime shoqërore e shëndetësore, për të cilat janë mbajtur, periodikisht, akt rakordimet përkatëse.

Në zbatim të VKM nr.117, datë 05.03.2014, “Për përmbajtjen, procedure dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qëndror të personelit”, të gjitha institucionet e administrates shtetërore janë të detyruara të krijojnë dhe të administrojnë dosjen e personelit të çdo të punësuarit, në institucionin e tyre, me të dhënat e karakterit teknik, profesional, masat disiplinore, vlerësimet periodike të rezultateve individuale në punë si dhe të dhëna të tjera, sipas cilësimeve të këtij vendimi.

Nga auditimi i kryer mbi administrimin e regjistrit qëndror të personelit rezulton se:

✓ Regjistri është i plotësuar me të gjitha të dhënat e nëpunësve, konform VKM 117/2014;

✓ Dosjet e nëpunësve, janë të plotësuara konform përcaktimeve të lidhjes nr.1 të VKM së sipërcituar dhe çdo dosje është e pajisur me fletëinventari e cila rezulton e firmosur nga nëpunësi dhe Përgjegjës e sektorit të Burimeve Njerëzore.

iv. Pagesat për punë jashtë kohës normale, shtesat mbi pagë, orët jashtë orarit. Rregullshmëria në krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë. Dhënia e shpërblimeve për rezultate në punë, ndihma për fatkeqësi, për nevoja kulturore, etj.

Për periudhën objekt auditimi fondi i veçantë është përdorur në shumën 148.000 lekë për 2 raste nga të cilat: 1 rast për dalje në pension në shumën 70.000 lekë dhe 1 rast fatkeqësi në familje në shumën 78.000 lekë.

Në 2 rastet e përdorjes së fondit të veçantë janë përdorur procedurat dhe masa e shpërblimit të parashikuar në VKM nr. 929, datë 17.11.2010 “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë” i ndryshuar dhe pika 38-40 të Udhëzimit plotësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.2, datë 19.01.2018 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018” i ndryshuar.

Në tabelën e mëposhme po paraqesim në mënyrë të përmbledhur planin dhe realizimin e fondit të pagave dhe sigurimeve shoqërore e shëndetësore të punonjësve

Nr.	Emërtesa	mijë/lekë					
		Plan 2017	Fakt 2017	Plan 2018	Fakt 2018	Plan 2019	Fakt 2019
1.	Paga	69,773	67,261	67,500	63,120	72,500	70,106
2.	Sigurime	11,900	11,008	13,500	10,395	13,500	11,638
	Totali i shpen. personeli	81,673	78,269	81,000	73,515	86,000	81,744

Burimi i të dhënave DPD

Për vitin 2017, zëri shpenzime personeli (paga, sigurime, shpërblime), është realizuar në shumën 78,269 mijë lekë nga 81,673 mijë lekë të planifikuara për tu shpenzuar, ose realizuar 95.8%.

Për vitin 2018, totali i shpenzimeve për pagat e personelit është planifikuar në vlerën 81,000 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 73,515 mijë lekë, ose realizuar në masën 90.8% e saj.

Për vitin 2019, zëri shpenzime personeli (paga, sigurime, shpërblime), është realizuar në shumën 81,744 mijë lekë nga 86,000 mijë lekë të planifikuara për tu shpenzuar, ose realizuar 95.1%.

Detyrimet e sigurimeve shoqërore janë llogaritur në zbatim të VKM nr. 1114, datë 30.07.2008 “Për disa çështje në zbatim të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë.....”, të ndryshuar, si dhe VKM nr. 700, datë 18.06.2009 “Për disa ndryshime në VKM nr.1114 datë 30.07.2008 “Për disa çështje në zbatim të Ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, ligjin nr.9136 datë 11.09.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nr. 10383, datë 24.02.2011 “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetsor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Tatimi mbi të ardhurat për çdo punonjës është ndalur konform Ligjit nr. 9766, datë 09.07.2007 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, të udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar.

2. Proceset gjyqësore në lidhje me marrëdhëniet e punës.

Në lidhje me marrëdhëniet e punës dhe zgjidhjen e kontratës së punës, DPD është si palë e paditur nga 2 ish punonjës:

- i. P. Kumaraku; dhe R. Trupja.

Paditësi, z. P. K., është emëruar inspektor në Kapitenerisë Durrës, i cili ka përfituar statusin e nënpunësit civil.

Me Urdhër të titullarit të DPD nr. 45, datë 25.05.2018, është bërë ndërprerjen e marrëdhënieve financiare nga detyra pasi nëpunësi është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale në kundërshtim me Ligjin nr 152/2013, “Për nëpunësin Civil”, neni 65, pika 1/d ku citohet se: “*Marrëdhënia në shërbimin civil përfundon për shkak të ligjit kur dënohet me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale*”.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Durrës, me Vendimin Nr. (82-2019-1778)537, datë 25.06.2019 ka rrëzuar padinë e z. Kumaraku dhe shpenzimet gjyqësore i ngarkohen paditësit. Paditësi ka bërë apelim për këtë vendim në Gjykatën e Apelit, Durrës.

ii. Znj. R. T. ka vendim të formës së prerë për rikthim në vendin e mëparshëm të punës me nr. 540, datë 03/12/2007, të Gjykatës së Apelit, Durrës.

Grupi i auditimit konstaton, se gjatë periudhës së Auditimit 2017-2019, është kryer një pagesë për punonjësen Zj. Rajmonda Trupja me urdhër shpenzim nr 21, datë 05.02.2018 në vlerën 198.240 lekë.

Nga ana e institucionit janë ndjekur të gjitha shkallët e gjyqësorit.

Përsa është konstatuar në këtë material, grupi i auditimit vlerëson se, komponentët e kontrollit të brendshëm janë vlerësuar nga niveli i lartë i menaxhimit, janë kryer procedurat e e parashikuar me hyrjen në fuqi të ligjit për nëpunësin civil, me përjashtim të 4 rasteve, si dhe është respektuar kuadri ligjor në fuqi për përcaktimin e sistemit të pagave dhe pagesave të tjera të lidhura me to.

V. Rekomandimet e auditimit

Në përfundim të projekt raport të auditimit, në lidhje me gjetjen e konstatuar nuk është lënë rekomandim, pasi nga institucioni janë marrë masat e duhura për përmirësimin dhe zbatimin e kërkesave ligjore për nëpunësin civil të administratës shtetërore.

VI. Komentet e subjektit të audituar.

Subjekti i audituar, ka dorëzuar zyrtarisht të firmosur një kopje të Projekt Raportit me shkresën nr. 1605/3 prot., datë 24.11.2020, protokolluar në MIE me nr. 6339/4, datë 26.11.2020.

VII. Falenderime.

Grupi i punës falenderon Stafin e Drejtorisë së Përgjithshme Detare, Durrës për gadishmërinë që treguan për vënien në dispozicion të dokumentacionit dhe bashkëpunimit gjatë gjithë kohës së kryerjes së angazhimit të auditimit.

GRUPI I AUDITIMIT

Merita GJOKA

Ardiana ALIMERI